



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN  
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:  
PROFILI MËSIMOR "SILVIKULTURË"**

**(DREJTIMI MËSIMOR "PYJE")**

**Janar, 2015**

## 1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të profilit mësimor “**Silvikulturë**”, me strukturë 2+2, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programin orientues për Provimet Përfundimtare në drejtimin “Pyje”, Niveli I;
- programet e lëndëve teorike profesionale të profilit “**Silvikulturë**”, Niveli III (klasa e 12-të dhe 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve. Për Bazat e sipërmarrjes, janë marë parasysh vetëm njohuritë e reja dhe jo veprimtaritë praktike.

## 2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për profilin mësimor “**Silvikulturë**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë

çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

### 3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “Teorisë profesionale të integruar” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për profilin mësimor “Silvikulturë”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Silvikulturë kl. 11 dhe kl. 12.
2. Fidanishte pyjore, kl 10 dhe kl. 13.
3. Detrologji, kl. 10.
4. Mbrojtje pyjesh, kl. 10.
5. Mbarështim pyjor, kl. 12 dhe kl. 13.
6. Teknologji shfrytezimi pyjor, kl. 12.
7. Bazat e sipërmarrjes, kl. 12 dhe kl. 13.
8. Dentrometri, kl. 11.
9. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshem, kl 13.

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues**

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Silvikulturë për prodhimin e objekteve prej	65	22
2	Fidanishte pyjore	45	15
3	Detrologji	46	15
4	Mbrojtje pyjesh	20	7
5	Mbarështrim pyjesh	46	15
6	Teknologjia e shfrytezimit pyjor	45	15
7	Bazat e sipërmarrjes	19	6
8	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
	<b>Totali</b>	<b>300</b>	<b>100</b>

a. **Silvikulturë**, kl.11 dhe kl.12:

(65 orë)

- Njohuri të përgjithshme për pyllin

2 orë

• Njohuritë morfologjike dhe Fiziologjike të drurëve të rritur në pyll	2 orë
• Katet e bimësisë	6 orë
• Karakteristikat e grumbujve pyjorë	7 orë
• Kujdesi për grumbujt pyjore	10 orë
• Prerjet kulturale	6 orë
• Rraportet mes pyllit dhe faktorëve klimatikë	10 orë
• Raportet mes pyllit dhe tokws	6 orë
• Mbarështrimi dhe trajtimi i pyjeve	2 orë
• Trajtimi i trungjishtes	6 orë
• Trajtimi i cungishtes të përbërëe	3 orë
• Trajtimi i cungjishteve	5 orë
<b>b. Fidanishte pyjore dhe pyllëzime artificiale, kl.10 dhe kl.13:</b>	<b>(45 orë)</b>
• Klasifikimi dhe zgjedhja e grumbujve farorë	4 orë
• Treguesit sasiore dhe cilësore të farërave	5 orë
• Veçoritë e mbjelljes farore	5 orë
• Veçoritë e përgjithshme të fidanishteve pyjore	3 orë
• Kriteret dhe procedurat e mbjelljes farave në fidanishte	10 orë
• Zgjedhja e llojeve	6 orë
• Teknikat e pyllëzimit	6 orë
• Pyllëzimi me farë	2 orë
• Pyllëzimi me kalem	2 orë
• Zonat e gjelbërta	2 orë
<b>c. Dentrologji, kl.10 dhe kl.11:</b>	<b>(46 orë)</b>
• Veçoritë e bimëve farore, farë veshura	10 orë
• Veçoritë e bimëve farore, fare xhveshura	15 orë
• Bimët mjeksore industriale	5 orë
• Instrumentet matëse	5 orë
• Kubimi i drurit të rrëzuar	5 orë
• Kubimi i drurit në këmbë	3 orë
• Kubimi i grumbujve pyjore	3 orë
<b>d. Mbrojtje pyjesh dhe e drurit, kl.10:</b>	<b>(20 orë)</b>
• Mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit që shkaktojnë faktorët klimatikë	2 orë
• Mbrojtja e pyjeve nga zjarri	1 orë
• Klasifikimi i insekteve në pyje	2 orë
• Insektet dëmtuese të haloreve dhe fletore	7 orë
• Insektet dëmtuese në fidanishte	3 orë
• Sëmundjet kryesore në pyje	5 orë
<b>e. Mbarështrimi i pyjeve dhe kullotave, kl.12 dhe kl.13:</b>	<b>(46 orë)</b> S((

• Njohuri të përgjithshme mbi mbarështrimin pyjor	3 orë
• Elementet tekniko ekonomike të mbarështrimit pyjor	2 orë
• Shfrytëzueshmëria forma dhe metodat e përcaktimit të saj	5 orë
• Fondi i prodhimit	5 orë
• Cikli i prodhimit	5 orë
• Mbarështrimi i cungjishteve të rregullta	3 orë
• Mbarështrimi i cungjishteve kopshtore	2 orë
• Mbarështrimi i cungjishteve	2 orë
• Studimi dhe përshkrimi i kushteve natyrore të prodhimit	5 orë
• Metodat e matjeve të grumbujve pyjorë	3 orë
• Bimësia e kullotave	5 orë
• Klasifikimi i kullotave	2 orë
• Përmirësimi i kullotave	2 orë
• Shfrytëzimi i kullotave	2 orë
<b>h. Teknologjia e shfrytëzimit pyjor, kl.12:</b>	<b>(45 orë)</b>
• Procesi i damkimit dhe prodhimit të asortimenteve drusore	10 orë
• Mjetet dhe mekanizmat që përdoren në procesin e shfrytëzimit pyjor	4 orë
• Transporti i brendshëm i materialit drusor	10 orë
• Depozitimi dhe ngarkimi i materialit drusor	2 orë
• Shfrytëzimi racional i pyjeve dhe ruajtja e materialit drusor	2 orë
• Organizimi i shfrytëzimit pyjor	10 orë
• Shfrytëzimi i prodhimeve të dyta pyjore.	4 orë
• Nxjerrja e esencave nga disa lloje drusore dhe barishtore	3 orë
rë	
<b>f. Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12:</b>	<b>(19 orë)</b>
• Sipërmarrja dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
• Sipërmarrja dhe biznesi	6 orë
• Tregu dhe sjellja konsumatore	5 orë
• Legjislacioni i punës	5 orë
<b>g. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13:</b>	<b>(14 orë)</b>
• Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	3 orë
• Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
• Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
• Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë